

# Një pjesë e re e mësimit për patentë shoferi mbi rreziqet (veturë, kategoria B)

Mësimi i detyrueshëm për patentë shoferi të kategorisë B mbi rreziqet, është shtuar që nga 1 prilli 2009 me një pjesë mbi alkoolin, drogat dhe lodhjen. Mësimi mbi rreziqet tani është i ndarë në dy pjesë:

- Pjesa 1 ka të bëjë me alkoolin, droga të tjera, lodhjen, si dhe sjelljet e tjera të rrezikshme.
- Pjesa 2 i përgjigjet mësimit të mëhershëm mbi rreziqet (pistë rrëshqitëse) dhe ka të bëjë me shpejtë- sinë, sigurinë dhe ngasjen e makinës në rrethana të veçanta.

Kur ta bësh provimin me shkrim dhe provimin e ngasjes, duhet të kesh kryer të dy pjesët e mësimit mbi rreziqet, pa skaduar afati. Kjo vlen edhe për ty që ke pasur patentë shoferi me herët dhe tani do të hysh në provim të sërishëm për patentë shoferi.

Mësimi mbi rreziqet vlen 5 vjet pas kryerjes së mësimit (risi nga 1 prilli 2009), por ky afat skadon po atë ditë që të lëshohet patentë shoferi.

## **PËRJASHTIM NGA DETYRIMI I KRYERJES SË MËSIMIT MBI RREZIOET, I NDARË NË DY PJESË**

Ka disa përjashtime nga rregulli i ri dhe këto vlejné në këto raste:

1. **Ti ke dhënë provimin e diturisë ose provimin e ngasjes para 1 prillit 2009 dhe ti ke kryer mësimin mbi rreziqet (pistë rrëshqitëse) para 1 prillit 2009:**
  - Ti nuk ke nevojë të kryesh mësimin mbi rreziqet i ndarë në dy pjesë, **për derisa vlejné provimi i dhënë si dhe mësimi mbi rreziqet.**
  - Nëse ka skaduar afati i provimit të diturisë ose provimit të ngasjes, por mësimi i vjetër mbi rreziqet (pistë rrëshqitëse) vlen akoma, atëherë duhet të kryesh pjesën e parë të mësimit të ri mbi rreziqet

Nëse ka skaduar afati i mësimit të vjetër mbi rreziqet (pistë rrëshqitëse), atëherë duhet kryesh të dy pjesët e mësimit të ri mbi rreziqet.
2. **Ti duhet të bësh provimin për të shfuqizuar kushtin për mjetin me kuti automatike të shpejtësive:**
  - Ti nuk ke nevojë të bësh një mësimit të ri mbi rreziqet.
3. **Ti ke një patentë shoferi dhe ke marrë urdhër të dorëzosh një dëshmi mbi dhënien e provimit të shoferit, që të kesh edhe më tutje të drejtë të posedosh patentën e shoferit:**
  - Ti nuk ke nevojë të bësh një mësimit të ri mbi rreziqet.

## **MË SHUMË INFORMACION**

Ti mund ta bësh mësimin mbi rreziqet tek një institucion arsimor i pranuar nga Drejtoria e transportit. Më shumë informacion mbi mësimin mbi rreziqet si dhe linku për te institucionet arsimore të pranuar ka në uebfaqen [www.korkortsportalen.se](http://www.korkortsportalen.se)

Ti, po ashtu, për pyetje mbi patentë shoferi mund ta kontaktosh Shërbimin e klientit të Entit rrugor në 0771-17 18 19.